

PARKU I NATYRËS “GËRMIA”, KRENARIA E KRYEQYTETIT


“Mund të krenohemi me bukuritë natyrorë të Gërmisë, por edhe më shumë duhet të jemi përgjegjës për ruajtjen e saj”

Kosova ndonëse një vendi i vogël për nga territori në Gadishullin Ballkanik karakterizohet me një varg të bukurive natyrore me vlera burimore, estetike dhe me fond gjenetik të llojeve bimore dhe shtazore të pasur. Nga sfondi i bukurive të rralla natyrore që posedon Kosova e të cilat janë me rëndësi kombëtare veçojmë edhe Masivin malor të Gërmisë.

Masivi malor i Gërmisë paraqet një pasuri natyrore shumë të rëndësishme jo vetëm për Prishtinën, rrethinën por edhe tërë Kosovën

Shtrihet në verilindje të kryeqendrës së Kosovës (Prishtinës) dhe përfshinë një sipërfaqe prej 62 km². Kufijtë e Gërmisë fillojnë prej kodrës së vreshtave në perëndim, pastaj në lindje të Prishtinës përmes kodrës së Mirditës deri te xeherorja e Ajvalisë e deri te rrjedha e lumit të Graqanicës, kufiri jugor shkon përmes rrjedhës së këtij lumi deri te derdhja e lumit të Busisë në të. Në lindje kufiri shtrihet përmes lumit të Busisë deri te fshati Mramor e Butos e pastaj deri te lumi i Prishtinës i cili është kufiri verior i këtij masivi malor. Pika më e lartë e Gërmisë është maja e Butosit me lartësi mbidetare prej 1050 m.

Relievi i Gërmisë përbëhet prej kodrave me lartësi dhe pjerrësi të ndryshme të ndara mes tyre me hapësira të luginave të përroskave dhe lumenjve. Këtu posaçërisht veçohet lugina e lumit Vellusha e cila buron në pjesën perëndimore të kodrës së Butosit, e cila edhe përfaqëson relievin më karakteristik me lartësi mbidetare 1000 m dhe gjatësi prej afro 8 km. Kjo pjesë shtrihet në mes të lumit të Prishtinës në veri dhe atij të Badocit në jug, e që njëkohësisht paraqet nyjen hidrologjike të lumit të Prishtinës, Vellushës dhe Badocit. Përndryshe në Gërmi ekzistojnë edhe mjaftë burime të cilat gjatë periudhës verore pjesërisht thahen. Sot uji i këtyre burimeve është i lidhur me një rrjetë që derdhet në pishinën e Gërmisë.



Pasuria floristike, vegjetative dhe faunistike e Gërmisë

Në sajë të pozitës gjeografike, veçorive gjeologjike, pedologjike, kushteve klimatike masivi malor i Gërmisë është mjaftë i pasur si në pikëpamje floristike, vegjetative dhe faunistike.

Nga hulumtimet e deritashme janë të evidencuara *610 lloje të florës vaskulare* të grumbulluara në 82 familje dhe *83 lloje kërpudhash* duke mos llogaritur taksonet e

barërave të këqija, atyre ruderales dhe bimëve tjera të ulta. Prej tyre 5 lloje janë endemike dhe 12 lloje mjekësore.

Vegjetacionin pyjor të Gërmisë e përbëjnë 4 bashkësi pyjore: *Bashkësia e shpardhit dhe qarrit (prej 600- 700 m lartësi mbidetare)*, *bashkësia e bungut dhe shkozës (800 m)*, *bashkësia e bungut (820- 870 m) dhe bashkësia e ahut (1000 m)*.

Kompleksiteti i biotopeve natyrore të Gërmisë siguron kushte për jetesën e një sërë llojesh shtazore. Sipas hulumtimeve të bëra deri më sot dhe sipas shënimeve të literaturës në regjionin e Gërmisë janë regjistruar: 5 lloje ujëtoksorësh, 7 lloje të rrëshqitësve, 19 lloje të gjitarëve dhe 30 lloje të shpendëve. Po ashtu jetojnë edhe një numër I madh I insekteve që përbëjnë grupin më të madh të shtazëve në këtë masiv.

Ndërsa të dhënat nga terreni sot janë alarmante, flitet për zhdukjen e shumë llojeve bimore dhe shtazore.

Statusi i ligjor i mbrojtjes së Gërmisë

Për shkak të bukurive të posaçme natyrore, vlerave burimore dhe estetike natyrore të cilat janë me rëndësi kulturore- arsimore, shkencore dhe turistike- rekreative kësaj zone I është kushtuar edhe një përkujdesje ligjore qysh herët.

Në vitin 1966 vendoset që një pjesë e masivit malorë të Gërmisë të shpallet si “*Pyje për piknik*” (“GZK” nr. 32/66). Në vitin 1987 Kuvendi Komunal I Prishtinës merr Vendim për vënien nën mbrojtje të Kompleksit të “Gërmia” në kategori të Parkut regjional i natyrës (“GZK” nr. 43/87). Me këtë është mbrojt sipërfaqja prej *1.126.01.00 ha*. Në bazë të këtij vendimi me Parkun e menaxhon OP. “*Hortikultura*”. Ndërsa mbikëqyrjen profesionale e bën Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Sipas IUCN (*Unionit botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës*) Parku i Gërmisë është evidentuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura (IUCN, 1990 United Nation List of National Parks and Protected Areas)

Gërmia vend i rekreacionit dhe i pushimit për qytetarët e Prishtinës

Mbi 75 % e sipërfaqes së Parkut të Gërmisë është e mbuluar me pyje mjaftë të ruajtura me bashkësi të shpardhit, qarrit, bungut dhe ahut. Një pjesë të rëndësishme të sipërfaqes së mbrojtur e përfshinë edhe zona për rekreacion dhe pushim, në të cilën gjenden edhe livadhe si dhe infrastruktura e ndërtuar.

Zona e pyjeve përfshinë *884.57.07 ha*, zona e kullotave *204.29.00 ha*, zona e livadheve *42. 55. 16 ha*, kopshteve *2.67. 54 ha*, toka jopjellore *14. 24. 79 ha* dhe zone e ndërtimeve dhe rrugëve *19. 67. 72 ha*.



Në kuadër të territorit të mbrojtur gjendet edhe zona për rekreacion dhe pushim, e cila përfshinë një sipërfaqe prej 41.40.52 ha. Zona për rekreacion dhe pushim fillon prej pishinës e më tutje në brendi të Gërmisë duke përfshirë livadhet, ish pushimoren e fëmijëve, terrenet sportive, ish hotelin e Gërmisë dhe deri te fillimi skiliftit.

Kjo zonë është e rrethuar me pyje të dushkut dhe të ahut, me pamje atraktive dhe është i dedikuar për pushim dhe rekreacion. Këto vlera atraktive natyrore dhe ajri i pastër i Gërmisë tërheqin vëmendjen që një numër i madh i banorëve të kryeqytetit dhe rrethinës të kalojnë një pjesë të ditës ose edhe fundjavën në të.

Problemet dhe ruajtja e Gërmisë

Nocioni mbrojtje e natyres përfshinë të gjitha hulumtimet, analizat dhe masat për ruajtjen dhe rivendosjen e ekuilibrit në natyrë. Ekuilibri i natyres duhet të ruhet për shkak të vlerave të saja dhe se është baza jetësore e shumë qenieve të gjalla: bimëve, shtazëve dhe e vete njerezve

Masivi malor i Gërmisë edhe pse në përgjithësi i ka ruajtur vlerat e veta natyrore, megjithatë ndikimi negativ i faktorit antropogjen nuk ka kaluar pa lënë gjurmët e veta. Janë të dukshme dëmtime të ekosistemeve ndryshme përmes eksploatimit të pyjeve dhe si rezultat i kësaj dukurie është paraqitë erozioni dhe rrëshqitja e tokës. Po ashtu kjo ndikuar edhe në çrregullimin dhe zvogëlimin e rrjedhave të ujit , e cila ka shkaktuar edhe ndryshueshmëri në strukturën e bashkësive jetësore bimore dhe shtazore.

Meqenëse Gërmia paraqet një rajon shumë të rëndësishëm dhe interesant në aspektin floristik, vegjetativ, faunistik dhe turistikë-rekreativ është e domosdoshme që të ndërmerren masa adekuate për mbrojtjen e sajë nga degradimi i mëtejshëm.



Për mbrojtjen e Gërmisë duhet para se gjithash: të respektohet ligji për mbrojtjen e natyrës, të hartohet plani hapësinor dhe plani zhvillimor i saja, të zgjerohet zona e mbrojtur dhe të mbrohen të gjitha vlerat e saja si masiv, nxitja e projekteve hulumtuese për vlerat natyrore të Gërmisë, ripërtëritja e hapësirave të degraduara me bashkësi autoktone, ndalimi i ndërtimit të objekteve dhe rrugëve në mënyrë të paplanifikuar, pastrimi i zonave të minuara dhe pastrimi i mbeturinave të ndërtesave nga bombardimet, ndalimin e hedhjes së mbeturinave, ndalimin e qarkullimit të automjeteve në brendësi përveç atyre zyrtare dhe shërbyese, mos ndryshimin e rrjedhave dhe burimeve natyrore të ujit, vendosja e tabelave informuese në vende të caktuara të Gërmisë, nxitja e programeve të vetëdijesimit për rëndësinë e vlerave natyrore të Gërmisë ,etj.



Prandaj për ruajtjen e Parkut të Gërmisë si zonë e mbrojtur por edhe të tërë masivit të Gërmisë nga degradimi i mëtutjeshëm duhet një angazhim më i madh duke filluar prej

qytetarit, ndërmarrjes menaxhuese, organeve komunale të Prishtinës, e deri te instancat më të larta shtetërore.

Pra duke e ditur se ruajtja e masivit të Gërmisë është me interes kombëtar dhe ndërkombëtar nuk duhet humbur shume kohë sepse edhe ashtu pak jemi të vonuar dhe koha nuk pret.

Ylber Sherifi

Instituti Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës